

RAPORT VJETOR 2010



PËRMBAJTTJA

VIZIONI DHE MISIONI	4
QËLLIMET DHE METODAT	4
MESAZH NGA UDHËHEQËSIA	5
KOHEZIONI SOCIAL DHE ZVOGËLIMI I VARFËRISË	6
MODERNIZIMI I ARSIMIT	6
MAQEDONIA PA DISKRIMINIM	9
NDËRMARRJET – MENAXHIMI ME MRFP	11
DIVERSIFIKIM, NDËRVARËSI DHE DIALOG I PRANUAR KULTUROR	12
MAQEDONIA – MODEL PËR DIALOG TË KULTURAVE	12
ZHVILLIM I QËNDRUESHËM LOKAL DHE RURAL	14
FURNIZIMI ME UJË I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT	14
ZHVILLIMI I KAPACITETEVE PËR RAJONIN PLANIFIKUES TË PELLAGONISË	15
SUNDIMI I DREJTË, PJESËMARRJA DHE POLITIKAT E DREJTUARA NGA DHE DREJT NJERËZVE	16
UDHËHEQJA E MIRË NË MAQEDONI	16
SHIOQËRI CIVILE E RRËNJOSUR DHE DINAMIKE	19
ZHVILLIMI INSTITUCIONAL I SHOQËRISË CIVILE	19
PROCES I MBËSHTETUR EUROINTEGRUES DHE BASHKËPUNIMI RAJONAL	22
MENAXHIMI ME RRJETIN BALLKANIK PËR ZHVILLIMIN E SHOQËRISË CIVILE	22
PARTNERITETE, MARRËDHËNIET ME OPINIONIN DHE MBËSHTETJA	23
MBËSHTETJE – MCMS I QËNDRUESHËM	24
ORGANIZIMI	25
KËSHILLI	25
KD	25
PERSONELI	26
ZYRA EKZEKUTIVE	26
MENDIM I PAVARUR I REVIZORËVE	27
RAPORT FINANCIAR	28

VIZIONI DHE MISIONI

Vizioni i MCMS është paqe, harmoni dhe prosperitet i njerëzve si në Maqedoni dhe në Ballkan dhe globalisht.

MCMS vizionin e vet e bazon në parimet universale të shoqërisë civile dhe demokracisë pjesëmarrëse, sundimin e të drejtës, zhvillim i barabartë dhe i qëndrueshëm socio-ekonomik, jo dhuna, respekti dhe ndërvlerësia dhe diversifikimi kulturor.

Misioni i MCMS është të udhëheqë dhe nxitë ndryshime me zgjidhje të reja dhe alternative për problemet shoqërore, të cilat ndikojnë te aktorët tjerë dhe të cilat inkuadrohen në rrjedhat kryesore.

QËLLIMET DHE METODAT

Qëllimet afatgjate të MCMS janë:

- ◆ Kohezioni social dhe zvogëlimi i varfërisë;
- ◆ Diversifikim, ndërvlerësi dhe dialog i pranuar kulturor;
- ◆ Zhvillim i qëndrueshëm lokal dhe rural;
- ◆ Sundimi i drejtë, pjesëmarrja dhe politika të orientuara nga dhe drejt njerëzve;
- ◆ Shoqëri civile e rrënjësuar dhe dinamike civile, që ndikon në politikat publike;
- ◆ Proces i mbështetur eurointegruar me bashkëpunim të forcuar rajonal;
- ◆ MCMS, organizatë e pavarur me kredibilitet, e aftë për partneritete të fuqishme dhe efektive dhe aleanca të bazuara në barazi (në nivel nacional, rajonal dhe ndërkombëtar);
- ◆ MCMS është organizatë atraktive dhe rinovuese e cila mëson, me rrënjë lokale dhe vështrim global.

MCMS aktivitetet i realizon nëpërmjet:

- ◆ avokimi (informimi; ngritja e vetëdijes dhe edukimi; krijimi dhe ndikimi mbi politikat; përcjellja dhe kërkimi i përgjegjësive);
- ◆ mbështetje zhvillimore (kapacitete dhe infrastrukturë);
- ◆ mbështetja sociale-humanitare

MESAZH NGA UDHËHEQËSIA

Në vitin 2010 pritej tejkalimi i krizës ekonomike globale dhe dalje nga recesioni ekonomik, duke përfshirë edhe për Maqedoninë, por në Evropë kjo u thellua me krizën e borxhit dhe krizën në euro zonën. Maqedonia pati përparim, mjaft të pabarabartë, në proceset e veta euro integruese, por pa përfundim me anëtarësimin në NATO dhe caktimin e datës për negociata për anëtarësim në BE, për shkak të kontestit me Greqinë. Ky vit ishte plot me sfida edhe për shoqërinë civile, para së gjithash nga aspekti i arritjes së qëndrueshmërisë, por edhe për shkak të çështjeve aktuale shoqërore.

Vitin afarist 2010 MCMS e përfundoi me sukses. MCMS në vitin 2010 pati vëllim të përgjithshëm (portfolio) prej 18 projekteve dhe buxhet prej 74 milionë denarë.

Realizimi i portfolios programore është i shkëlqyeshëm – 90% nga plani, ndërsa i buxhetit 98%. Në raport me gjendjen me shoqërinë civile dhe të drejtat e njeriut, vitin 2010 e shënuan debatet dhe miratimi i ligjeve të rëndësishëm, për shoqatat dhe fondacionet, si dhe për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Të dy ligjet vite të tëra ishin në rend dite të shoqërisë civile dhe të MCMS-së. Përpjekje të pasuksesshme për miratimin e tyre pati në vitin 2006, gjegjësisht 2005. Miratimi i të dy ligjeve shkaktoi debat në shoqërinë civile, ndërsa LPMD shkaktoi edhe diskutim të gjerë shoqëror. Debati për të dy ligjet i theksoi dallimet, jo aq në përmbajtjen, por në qasjen, në shoqërinë civile, veçanërisht mes FISHHM dhe MCMS-së.

Këtë vit përfundoi programi Furnizimi me ujë i komunës së Jegunovcit (VOJ), me çka u rumbullakua një nga aktivitetet më të vjetra dhe që më së shumti njihen të MCMS nga themelimi deri më tani – furnizimi me ujë i fshatrave, veçanërisht në rajonet kodrinore-malore dhe të marginalizuara.

Në masë të madhe edhe për shkak të ligjeve të përmendura, vazhdoi edhe u intensivkua bashkëpunimi në kuadër të sektorit civil (rrjetet PQM, MPD dhe BCSDN) dhe me institucionet shtetërore, përmes anëtarësimit në Komitetin e përbashkët për shoqëri civile të BE-RM, Këshillit nacional për integritet evropiane, por edhe me takimet e drejtpërdrejta me deputetët dhe përfaqësuesit e ministrive kompetente. U intensivkua edhe bashkëpunimi me Komisionin shtetëror për pengimin e korrupsionit. Komiteti i përbashkët për shoqëri civile të BE-Maqedonisë luajti rol të rëndësishëm në procesin e integriteteve evropiane të Republikës së Maqedonisë. Në fund të vitit 2010 MCMS përsëri u zgjidh për anëtare e KPK në mandatin e ri.

MCMS si pjesë e shoqërisë civile ballafaqohet me sfidat, ndryshimet dhe problemet e njëjta. MCMS dëshmoi se ka kapacitet të lartë për përshtatje në ndryshimet e shpejta të cilat ndodhin në shoqëri. MCMS në vitin 2011, E përfundon periudhën afatmesme (nga viti 2008). E ngjashme është situata edhe me dy organizatat të cilat MCMS i menaxhon – MRFP dhe BCSDN. Viti 2011 është viti ku përfundon ristrukturimi i plotë i burimeve të financimit (dhe mbështetja) dhe e organizimit të brendshëm të MCMS. Kjo, në vitin e 18-të të ekzistimit do ta sigurojë përgatitjen e nevojshme të MCMS për ballafaqimin me sfidat e reja.



Sasho Klekovski
drejtor i parë
ekzekutiv



Aleksandar
Kërzhhalovski
drejtor ekzekutiv

KOHEZONI SOCIAL DHE ZVOGËLIMI I VARFËRISË

MODERNIZIMI I ARSIMIT

Qëllimi është të kontribuohet drejt avancimit të kualitetit të mësimit dhe rritjes së pjesëmarrjes në mësim në shkolla.

Gjatë vitit 2010 u meremetuan dy shkolla fillore në mjediset rurale: Angjellci dhe Kukureçani, derisa në dy të tjerat në Konçe dhe Cërnilishtë, morëm libra dhe mjete. Projekti është vazhdim i aktiviteteve të cilat u realizuan në tre vitet e kaluara. Sokotab në bashkëpunim me partnerët e vet siguruan mjete për meremetimin e mëtejshëm të shkollave rurale në rajonet ku mbisundon prodhimi i duhanit oriental.

SHKOLLA DO TË SHËRBEJË NË 100 VITET E ARDHSHME

“Kur do binte shi, xhaxhi Gjorgje menjëherë vraponte përreth dhe vinte kova në vendet ku do pikonte nga çatia” – kështu e përshkruan me gjallëri nxënësi i klasës së gjashtë Petri gjendjen në shkollën Goce Dellçev në f. Angjelci, para meremetimit. Por çatia që pikonte tani më është e kaluar, prandaj Petri, i veshur në veshje kombëtare nga rrethi i Strumicës, me buzëqeshje rrëfen për mundimet e amvisi dhe të të gjithëve që kanë punuar dhe mësuar në shkollë.

Rreth 150 nxënës në këtë shkollë fillore tashmë disa muaj mësojnë në kushte më të mira. Ata, me ndihmën e arsimtarëve dhe prindërve të vet u përgatitën dhe më 14 dhjetor i pritën mysafirët që erdhën t’ua urojnë suksesin. Korridori ishte i ngushtë që ti grumbullojë prindërit e kënaqur, që kishin ardhur të dëgjojnë dhe ti shohin pikat që i kishin përgatitur fëmijët e tyre. Pak në maqedonishte, pak në turqishte, sepse në shkollë mësojnë edhe fëmijë të bashkësisë etnike turke, renditeshin këngët, recitimet, vallet, pikat ritmike, drama...

Mysafirët, ministri i Arsimit dhe Shkencës, Nikolla Todorov, përfaqësuesit e donatorëve të MCMS dhe TIKS dhe kryetari



Foto. 1 Nga programi i përgatitur nga arsimtarët dhe fëmijët për mysafirët e tyre

i komunës së Vasilvës u dëshiruan nxënësve dhe arsimtarëve edhe shumë vite të gjata ta shfrytëzojnë shkollën dhe të arrijnë suksese të shkëlqyeshme.

Shkolla është ndërtuar në vitin 1946 dhe pjesërisht e meremetuar në vitin 1997. Me këtë meremetim janë përtërirë muret e brendshme dhe të jashtme, dyshemeja, çatia, tavanet, dritaret dhe dyert, është vendosur instalim i ri elektrik dhe instalimi për ngrohje qendrore.

“Në shkollë të këtillë është kënaqësi të mësohet dhe punohet, tha në fjalimin e saj drejtoresha Gordana Janeva.

DRITARE TË REJA PËR SHKOLLAT NË KOMUNËN E AERODROMIT

Në fund të tetorit 2010, në SHF “Vëllezërit Milladinovci”, në Shkup, u mbajt sesiioni i fundit i forumeve, në kuadër të programit Forumet në bashkësi në komunën e Aerodromit. Në periudhën nga tetori 2009 deri në prill 2010 u mbajtën 7 sesione të forumeve, banorët i votuan projektet: rikonstruimi i dritareve dhe dyerve në shkollat fillore “Bllazhe Koneski”, “Vëllezërit Milladinovci”, “Goce Dellçev” dhe kopshtin “Izvorçe”. U ndërruan gjithsej 307 dritare dhe dyer që do të mundësojnë zhvillim më cilësor të mësimin dhe përmirësimi i efikasitetit energjetik.

“Në këtë proces u kyça që nga fillimi, si përfaqësues i organizatave civile, tha Done Nikollovski, kryetar i Lidhjes për parandalim nga alkoolizmi, nikotinizmi dhe narkomania të Maqedonisë.



Foto. 2 Dritaret e reja për shëndet më të mirë të nxënësve deh kursim të energjisë

“Mendoj se i gjithë procesi zhvillohej me shumë sukses, objektivisht, me aktivitet të madh nga të gjitha strukturat, si nga qytetarët, arsimtarët dhe përfaqësuesit e komunës. Ky projekt me sukses u realizua, edhe krahas asaj që ka edhe probleme tjera, por ato shpresoj do të zgjidhen me programin e komunës. Mendoj se edhe më tej qytetarët duhet të inkuadrohen në vendimmarrjen dhe zhvillimin e komunës”, na deklaroi Nikollovski.

Shuma përgjithshme e projektit është rreth 7,5 milionë denarë, të siguruar nga Agjencia zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC) dhe komuna e Aerodromit. MCMS e udhëhoqi gjithë procesin e forumit.



MAQEDONIA PA DISKRIMINIM

Qëllimi i programit është zhvillimi i mëtejshëm i rrethinës mundësuese për mundësi të barabarta të gjithë njerëzve, gjegjësisht jo diskriminimi në Maqedoni.

Ky program, në pjesë të madhe u realizua në kuadër të Lidhjes Maqedonia pa diskriminim, themelues i të cilës dhe një nga 10 anëtarët është edhe MCMS. Një nga aktivitetet më të rëndësishme ishte miratimi i Ligjit për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. U botua dhe u promovua publikimi “Analiza e standardeve dhe praktikave më të mira dhe ligjet, politikat dhe planet ekzistuese nacionale të legjislativit anti diskriminues”, ndërsa u përgatit edhe Raporti për gjendjen me diskriminimin në Maqedoni në vitin 2009 dhe 2010. U organizua edhe vizitë studimi në Bruksel, Belgjikë, në temën “Forcimi i kapaciteteve për luftë kundër diskriminimit” për 12 përfaqësues të institucioneve të ndryshme shtetërore dhe OQ.

U MIRATUA LIGJI PËR PENGIMIN DHE MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI



Foto. 3 Lidhja MPD ishte shumë aktive në procesin e formulimit dhe miratimit të Ligjit

U miratua Ligji për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. MCMS mori pjesë aktive në mbledhjet e komisioneve kuvendore, ku u diskutua Ligji i propozuar për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi (LPMD) dhe në kuadër të Lidhjes Maqedonia pa diskriminim, propozoi 33 amendamente, nga të cilat gjysma u pranuan. Pas miratimit të LPMD u organizuan edhe punëtori të Trupit nacional koordinues për jo diskriminim, ku u diskutua për formimin e Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi. U organizua edhe punëtorja “Sfidat për zbatimin e Ligjit për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi”.

U REALIZUA HULUMTIMI “DISKRIMINIMI NË BAZË TË PËRKATËSISË ETNIKE”

MCMS me mbështetje financiare të OSBE, ndërsa në bashkëpunim me Sekretariatit për implementimin e Marrëveshjes kornizë të Ohrit pranë Qeverisë së RM e realizoi hulumtimin Diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike. Në publikimin është bërë pasqyrë e rregullativës ligjore rreth diskriminim, si edhe hulumtimi i diskriminimit në fusha të ndryshme: punësimi, arsimi, të mirat dhe shërbimet, mbrojtja sociale dhe shëndetësia dhe mediet.

Fushat më të shpeshta të diskriminimit, sipas përvojave personale të qytetarëve janë: marrëdhëniet e punës (punësimi), shërbimet në sektorin publik (administrata publike, e veçanërisht policia dhe shërbimet shëndetësore), por edhe në shërbimet private (kafe-baret, diskotekat, pishinat), si dhe në arsim.

Për të gjithë sektorët veçmas të hulumtuar mbisundojnë mendimet se ka diskriminim, me çka për katër sektorë (shëndetësia, arsimi, gjyqësia dhe siguria/policia) këto janë mendime shumicë (mbi 50% të anketuarve). Ambicia e këtij dokumenti është shqyrtimi i realitetit nga aspekti i të dhënave të qasura, kompletimi i dukurive të incidenteve për të cilat në opinion ka pasur perceptim për diskriminim në bazë etnike dhe potencomi i fushave potenciale të diskriminimit të mundshëm ku në të ardhmen duhet ti kushtohet vëmendje.



NDËRMARRJET – MENAXHIMI ME MRFP

MCMS i kryen të gjitha punët udhëheqëse, profesionale dhe administrative për Fondacionin Zhvillimor Maqedonas për Ndërmarrjet (MRFP).

Në vitin 2010 janë paguar 197,249,682 denarë për 966 klientë. Realizimi në këtë vit është për 4,6% më shumë në raport me shumën e planifikuar vjetore të pagesave kreditore, ndërsa 86,2% në raport me numrin e planifikuar të klientëve të ri në vitin 2010. Me këto kredi janë mbështetur 1,748 vende pune, ndërsa me shfrytëzimin e kredive në drejtim të zgjerimit të veprimtarisë së tyre, këto ndërmarrje planifikojnë të punësojnë 147 punëtorë. Me këtë të fundit, numri i përgjithshëm i arritur i shfrytëzuesve deri më 31.12.2010 ishte 8,820, me çka gjithsej janë mbështetur 14,627 vende ekzistuese pune dhe 2,994 të planifikuara.

U realizua vizitë studimi në Slloveni për IPARD për përfaqësuesit e institucioneve financiare, ndërsa u siguria edhe mbështetje financiare për përpunimin e softuerit për vlerësimin e mikro kredive.



Foto. 4 Nga vizita qumështores Celepa gjatë vizitës së studimit në Slloveni

MRFP siguroi mbështetje programore dhe organizative për zbatimin e aktiviteteve programore të LOE, OEMVP dhe të grupi për zhvillimin e nën-sektorit domatja dhe speci deri në vitin 2011. Në bashkëpunim me Qendrën për zhvillim të bizneseve të reja (BSC), MRFP e realizoi anketimin si pjesë të procesit të hulumtimit më të madh për sipërmarrjen në botë (GEM) për vitin 2010.

Në fund të gjysmë vjetorit u realizua tepricë e të ardhurave mbi shpenzimet në vlerë prej 34,948,097 denarë, që paraqet 6,2% më shumë në raport me atë që u planifikua në nivel vjetor.

Më shumë informata për arritjet e MRFP mund të gjeni në www.mrfp.org.mk

DIVERSIFIKIM, NDËRVARËSI DHE DIALOG I PRANUAR KULTUROR

MAQEDONIA – MODEL PËR DIALOG TË KULTURAVE

Qëllimi i programit është përmirësimi i marrëdhënieve ndëretnike përmes institucionalizimit të modeleve të suksesshme.

Në këtë vit, u zbatuan tre projekte në kuadër të këtij programi: Ura; Forcimi i dialogut përmes Marrëveshjes kornizë të Ohrit; dhe Analiza e implementimit të Marrëveshjes kornizë të Ohrit.

Në projektin Ura u realizuan katër nga tetë vizitat e shkëmbimit të përvojave mes Maqedonisë dhe Irlandës veriore.

Vizitat e studimit u përqendruan në reformat e zbatuara në fushën e policisë dhe drejtësisë dhe të vetëqeverisjes lokale.

Në bashkëpunim me ADI, Gostivar, u përgatit analiza në temë “Integrimi i bashkësive jo shumicë nën 20% në nivel qendror dhe lokal përmes legjislativës juridike në institucionet në Maqedoni”.

VIZITA STUDIMI PËR VETËQEVERISJEN LOKALE

Këtë vit u realizuan dy vizita studimi të fokusuar në përvojat nga funksionimi i vetëqeverisjes lokale, njëra në Maqedoni dhe tjetra në Irlandën Veriore.

Vizita e parë u realizua në tetor në Maqedoni. Delegacioni prej 12 përfaqësuesve të rrethit Omag, nga Irlanda Veriore dhe qyteti Sligo i Republikës së Irlandës i vizituan komunat e përfshira me konfliktin nga viti 2001 dhe patën takime me përfaqësues të Ministrisë për Vetëqeverisje Lokale, BNJVL e tjera.

“E identifikua sfidën e ofrimit të shërbimeve në shoqëri të ndarë. Dërgimi i atyre shërbimeve në mënyrë demokratike, e zbulon mbështetjen e shumicës dhe pakicë dhe gjithashtu i zbulon dallimet institucionale, administrative dhe financiare. Përshtypja e përgjithshme është se paanësia është standardi më i rëndësishëm dhe kërkesa themelore e qytetarëve”, thotë Xho Leonard, kryesues i Këshillit të Sligo. Sipas tij frustrimet shpesh rriten për shkak të kufizimeve financiare dhe artikulohen si dominim etnik. “Korrupsioni politik duket se është problem në vendimmarrjet dhe në procesin e alokimit financiar”, shtoi ai.



Foto. 5 Pjesëmarrësit dhe nikoqirët gjatë vizitës së studimit në Omag, Irlandë Veriore

Në dhjetor, 13 përfaqësues të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale, Universitetit të Evropës Juglindore, komunave të Tetovës. Jegunovcit dhe Tearcës; Bashkësia e Njësisive të Vetëqeverisjes Lokale dhe organizata qytetare “Qendra për edukim dhe zhvillim” nga Tearca dhe MCMS ishin për vizitë në Omag (Irlandë Verore). “Me vizitën e Irlandës Veriore pata rast të njoftohem me marrëdhëniet më të ndryshme shoqërore dhe aktorët nga ato në Republikën e Maqedonisë. Unë nuk jam analist politik, por përshtypja ime është se dallimet në Irlandën Veriore më vështirë do të mund të “hekurosen” edhe krahas përpjekjeve të vazhdueshme të individëve dhe grupeve”, thotë Vojislav Antovski nga komuna e Jegunovcit.

ZHVILLIMI QËNDRJES HËM LOKAL DHE RURAL

FURNIZIMI ME UJË I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT

Qëllimi i programit është të sigurohet qasje deri të sasisë e mjaftueshme të ujit të shëndoshë për pije në bashkësitë nga komuna e Jegunovcit. Fokusi ishte

përmirësimi i furnizimit me ujë në 12 fshatra nga ish komuna e Jegunovcit, si edhe në f. Ozormishtë nga komuna e Zhelinës.

UJËSJELLËS I RI PËR 12 VENDBANIME

Më 23 tetor 2010 në Jegunovc u lëshua në përdorim ujësjellësi i ri, me të cilin morën sasi të mjaftueshme të ujit të shëndoshë për pije pothuaj 8.500 banorë të 12 vendbanimeve.

Përfundimi i këtij ujësjellësi, i vuri fund problemeve të banorëve me ujin e bakteologjikisht të parregullt, i cili mund ta rrezikonte shëndetin e tyre.


“Qytetarët tanë e ndejnë këtë projekt si të vetin”, tha Toni Koceski, kryetar i komunës së Jegunovcit. Ai iu falënderua qytetarëve, të cilët mundësuan pa kompensim të kalojë vija e ujësjellësit nëpër pronën e tyre private.



Foto. 6 Nga e majta: Nikolla Gruevski, Toni Kocovski, Kjetil Paulsen, Sasho Klekovski dhe Abdylaqim Ademi

Financat për ndërtimin e ujësjellësit u siguruan nga Mbretëria e Norvegjisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. “Ujë i pastër për të gjithë është parakusht për mirëqenien dhe prosperitetin”, tha në fjalën e tij ambasadori i Norvegjisë, Kjetil Paulsen.

Në hapjen, u drejtua edhe kryeministri i Qeverisë së RM, Nikolla Gruevski. “Ky projekt, si dhe shumë të tjerë që i mbështetëm, flet qartë për përkushtimin e Qeverisë që ti zgjidh problemet e qytetarëve”, tha ai. “Sfida për banorët e Jegunovcit qëndron tani”, tha në fjalimin e tij Sasho Klekovski, drejtor i parë ekzekutiv i MCMS, “ai është i reflektuar në sloganin ‘Llogari e pastër – ujë i shëndoshë’. Shprej se ky mund trevjeçar do të mbahet ashti siç duhet”, shtoi ai.



ZHVILLIMI I KAPACITETEVE PËR RAJONIN PLANIFIKUES TË PELLAGONISË

Qëllimi është kapacitete të forcuara të aktorëve të cilët kontribuojnë drejt qëndrueshmërisë dhe zhvillimit të Rajonit planifikues të Pellagonisë. Deri në

fund të vitit u organizua promovimi i projektit dhe trajnimeve: për zhvillim të projekteve, për aspektet juridike dhe organizative të partneriteteve publike private dhe për biznes shkathtësitë dhe mundësitë për financimin e bizneseve.

PROMOVIMI I PROJEKTIT

Në fund të shtatorit 2010, në Shtëpinë e kulturës në Manastir, me konferencë promovuese filloi realizimi i projektit Mbindërtimi institucional për koordinim dhe mbështetje të biznes aktiviteteve në Rajonin planifikues të Pellagonisë. “Të gjithë bashkë do të krijojmë zhvillim dinamik i cili do të jetë i dobishëm për të gjithë 240.000 banorët e rajonit. Do të ndërtojmë partneritet gjatë gjithë vitit, që do të zgjatin në të gjitha vitet e ardhshme tona”, tha Emilija Gjeroska, udhëheqëse e Qendrës për zhvillim të Rajonit planifikues të Pellagonisë. Qëllimi i projektit është të vendosen ekipe të organizuara dhe të strukturuar për çdo komunë dhe për Qendrën, të cilat do të jenë të afta ti koordinojnë dhe ti mbështesin biznes aktivitetet në rajon. Projekti është përgjegjësi e Qendrës për zhvillim të Rajonit planifikues të Pellagonisë, ndërsa MCMS do të realizojë trajnimet për administratën komunale dhe biznes sektorin.



Foto. 7 Fillimi i projektit nxiti interesim të madh te kryetarët e komunave nga rajoni

Projekti financiarisht është mbështetur nga Byroja për zhvillim rajonal, si pjesë e programit për zhvillim të barabartë rajonal të Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale të RM. Mjetet janë siguruar nga buxheti i RM dhe komunave të Rajonit planifikues të Pellagonisë: Manastiri, Prilepi, Resnja,

Krusheva, Demir Hisari, Novaci, Mogilla, Dollneni dhe Krivogashtani.

Në trajnimin për partneritet publik – privat morën pjesë 54 përfaqësues nga sektori publik dhe privat.



Foto. 8 Gjatë trajnimit për partneritet publik-privat morën pjesë 54 përfaqësues nga sektori publik dhe privat

SUNDM I DREJTE, PJESEMARRJA DHE POLITIKAT E DREJTUARA NGA DHE DREJT NJERËZVE

UDHËHEQJA E MIRË NË MAQEDONI

Qëllimi i programit është përgjegjësia e rritur e institucioneve, organizatave qytetare dhe qytetarëve.

Këtë vit, pjesë e aktiviteteve të realizuara ishin: vizitë studimi në Shqipëri në temën “Buxhetimi participativ” e organizuar në bashkëpunim me ADI; dy trajnime për Shoqatën për mbrojtje dhe edukim të fëmijëve dhe të rinjve romë “Progres” në temat “Hyrje në krijimin e politikave dhe zhvillimi i shkathtësive për mediat” dhe “Krijimi dhe vlerësimi i politikave publike rinore”. Në trajnimet morën pjesë 34 të rinj, u përgatit dhe u botua doracaku “Të rinjtë – krijues të politikave”. U botua dhe u promovua raporti për gjendjen me korrupsionin në Bullgari me titull “Krimi pa dënim”. Në temën “Mekanizmat për luftë kundër korrupsionit – përvojat nga Bullgaria” u organizuan katër ngjarje informative në Manastir, Gostivar, Veles dhe Strumicë. Në bashkëpunim me OSBE u përgatit analiza për miratimin publik dhe transparent të ligjeve, që përmban pjesë krahasuese me përvojat nga më shumë vende nga Evropa. Me qëllim të vendosjes së qasjeve participative për caktimin e nevojave prioritare në bashkësitë në vitin 2010 MCMS zbatoi forume në gjashtë komuna: Resnjë, Manastir, Aerodrom, Berovë, Radovish dhe Konçe.

BUXHETIMI PARTICIPATIV

MCMS në partneritet me Asociacionin për Iniciativa Demokratike (ADI) nga Gostivari, në prill të vitit 2010, në Tiranë, Republika e Shqipërisë, organizoi vizitë studimi në temë buxhetimi participativ. Pjesëmarrës në trajnim ishin njëmbëdhjetë përfaqësues të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, vetëqeverisjes lokale, Universitetit “American college” dhe disa organizata qytetare. Qëllimi i vizitës së studimit ishte tu mundësohet pjesëmarrësve që të njoftohen me praktikën më të mira për qasje participative në vëzhgimin dhe vlerësimin e procesit buxhetor në Republikën e Maqedonisë.

Institucionet relevante shtetërore dhe organizatat qytetare, pjesëmarrësve ua prezantuan rregulloren juridike dhe përvojat gjatë implementimit të buxhetimit participativ në nivel nacional dhe lokal. Pjesëmarrësit e vizituan Shoqatën e komunave të Shqipërisë, Parlamentin, ndërsa patën takime edhe me përfaqësues të Komisionit parlamentar për ekonomi dhe financa. Në Ministrinë e Financave iu prezantua procesi i përgatitjes së buxhetit dhe qasja e tyre drejt procesit programor buxhetor. Një pjesë e praktikave të mira ishin në sektorin qytetar. Pjesëmarrësit e vizituan Institutin për



Foto. 9 Pjesëmarrësit gjatë vizitës së studimit në Bullgari

hulumtime urbane, i cili e implementoi buxhetimin participativ në tre bashkësi lokale. E vizituan edhe Institutin për hulumtime shkencore „Co-Plan“.

DORACAK PËR BUXHETIM PARTICIPATIV

MCMS në bashkëpunim me Amerikan kolegjin nga Shkupi e botoi Doracakun për buxhetim participativ autorë të cilit janë doc. dr. Nikica Mojsoska – Bllazhevski dhe mr. Misho Nikollov. Publikimi iu është dedikuar organizatave qytetare, nëpunësve shtetëror, studentëve dhe opinionit të gjerë, që t’ju ndihmojë të njoftohen me bazat dhe faktet për buxhet të Republikës së Maqedonisë, për ekonominë e të hollave publike dhe për konceptin e buxhetimit participativ. Kjo duhet të mundësojë që buxheti të lexohet lehtë, ndërsa qytetarët të jenë aktorë aktiv në debatin për buxhetin, si për atë nacional ashtu edhe lokal.

MEKANIZMAT PËR LUFTË KUNDËR KORRUPSIONIT – VIZITË STUDIMI

MCMS në bashkëpunim me Qendrën për hulumtim të demokracisë (CSD) nga Sofja organizoi vizitë studimi në temën: “Anti korrupsioni – mekanizmat për luftë kundër korrupsionit, përvojat dhe sfidat e Bullgarisë”. Vizita u zhvillua në nëntor të vitit 2010, në Sofje, Republika e Bullgarisë. Në delegacionin maqedonas morën pjesë: tre deputetë nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, kryetari i Këshillit republikan gjyqësor, prokurori publik për kriminalitet të organizuar, kryetari i KSHPK, përfaqësuesi nga Sekretariati gjeneral i Qeverisë, përfaqësuesi nga departamenti për kriminalitet të organizuar dhe korrupsion pranë MPB, përfaqësues nga BNJVL dhe katër përfaqësues nga sektori civil.

Qëllimi i vizitës ishte që pjesëmarrësit të fitojnë fotografi të plotë për mekanizmat për luftë kundër korrupsionit në Bullgari si vend anëtare e BE dhe të dëgjojnë për përvojat dhe sfidat e Bullgarisë në ballafaqimin me korrupsionin.

Kjo duhet të kontribuojë për njoftimin më të mirë me problemet lidhur



me korrupsionin me të cilat Republika e Maqedonisë mund të ballafaqohet në të ardhmen. Pjesëmarrësit kanë mundësi të takohen me përfaqësuesit e: Inspektoratin e Këshillit suprem gjyqësor, Prokuroria supreme dhe Inspektoratin pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, që janë të obliguara për zbatimin e mekanizmave për luftë kundër korrupsionit në Republikën e Bullgarisë, Asociacioni nacional i komunave të cilat kanë rol aktiv në krijimin e politikave dhe rregullave për zvogëlimin e korrupsionit në nivel lokal. Gjithashtu pjesëmarrësit patën mundësi të marrin pjesë edhe në mbledhjen e Komitetit për pengimin e korrupsionit, konflikti i interesave dhe etikës parlamentare në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë.

“KRIMI PA DËNIM”

MCMS e ribotoi dhe promovoi Raportin për luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në Bullgari “Krimi pa dënim”. Raporti është përgatitur nga Qendra për hulumtim të demokracisë nga Bullgaria. Në këtë mënyrë, MCMS dëshiron të kontribuojë drejt analizës së politikave dhe diskutimeve për çështje të rëndësishme shoqërore me fokus të korrupsionit.



SHOQERI CIVILE E RRENJOSUR DHE DYNAMIKE

ZHVILLIMI INSTITUCIONAL I SHOQËRISË CIVILE

Qëllimi i programit është krijimi i rrethinës mundësuese për funksionim efikas të organizatave qytetare.

Këtë vit një pjesë e aktiviteteve të realizuara ishte Ligji i ri i miratuar për shoqatat dhe fondacionet (LSHF). MCMS përgatiti mendim të veçantë, ndërsa për ligjin e ri u organizuan pesë ngjarje informative në pesë qytete, ku morën pjesë 98 përfaqësues të OQ. U organizua vizitë studimi në Beograd, ku morën pjesë shtatë përfaqësues të institucioneve relevante shtetërore në kompetenca të cilit është përgatitja e akteve nënligjore dhe zbatimi i Ligjit. U botua edhe publikimi “Financimi i organizatave qytetare nga ana e shtetit”, ndërsa u përgatit edhe raporti për zbatimin e Strategjisë për bashkëpunim të Qeverisë me sektorin civil.

Anketa e zbatuar organizative rezultoi me raport hulumtues “Vetëperceptimi për shoqërinë civile”. Përveç kësaj, u realizuan edhe tre anketa: Vlerat shoqërore maqedonase; Besimi në Maqedoni dhe Përgjegjësia shoqërore e qytetarëve. U mbajtën edhe dy mbledhje të Komitetit të përbashkët konsultativ (KPK) të shoqërisë civile të Republikës së Maqedonisë dhe bashkimit Evropian. MCMS realizoi nëntë trajnime dhe konsultime për 132 përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, institucionet shtetërore dhe publike.

U MIRATUA LIGJI I RI PËR SHOQATAT DHE FONDACIONET

Ligji për shoqatat dhe fondacionet (LSHF) është një nga ligjet më të rëndësishme për shoqërinë civile në Maqedoni. Ai është ligji themelor që e rregullon punën e organizatave qytetare. Që nga viti 1995, MCMS iu përkushtua përmirësimit të kornizës ligjore për shoqërinë civile. MCMS mori pjesë që nga vetë fillimi në përgatitjen e tekstit të ligjit të ri, në kuadër të grupit punues të Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa përfaqësues të saj morën pjesë në mbledhjet e Komisionit për sistem politik dhe marrëdhënie mes bashkësive dhe Komisionit ligjdhënës-juridik.

Risite kryesore që i sjell Ligji për shoqatat dhe fondacionet janë: zgjerimin e të drejtës dhe lirive të shoqërimit, zvogëlimin e ngarkesës mbi shoqatat në kuptim të numrit të obliguar të organeve, përmirësimin e masave për gjenerimin e të ardhurave, kontributin drejt udhëheqjes së mirë dhe transparencës, sqarimi i dispozitave përmes fjalorit, orientimi drejt zgjidhjes së problemeve nga praktika etj.

Me qëllim të informimit më të madh të organizatave qytetare për ligjin e ri dhe risitë, në maj dhe qershor 2010 u organizuan pesë ngjarje informative për LSHF në Manastir, Gostivar, Veles dhe Shkup, ku morën pjesë 98 përfaqësues nga organizatat qytetare.



Foto. 11 Nga ngjarja informative për LSHF në Shkup



VAZHDOI ME PUNË KPK PËR SHOQËRI CIVILE TË BE DHE REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në vitin 2009 filloi me punë Komiteti i përbashkët konsultativ (KPK) i shoqërisë civile të BE dhe Republikës së Maqedonisë. KPK është trup i përbashkët konsultativ i cili ka për qëllim të vëzhgojë marrëdhëniet mes BE dhe Republikës së Maqedonisë nga pikë vështrimi i shoqërisë civile. KPK i promovon kontaktet dhe diskutimin mes përfaqësuesve të shoqërisë civile të dy palëve për çështje me interes të përbashkët. Gjatë vitit 2010 u mbajtën tre mbledhje të PKK.

Maqedonia ishte nikoqir i takimit të dytë të Komitetit të përbashkët konsultativ, i cili u mbajt në shkurt në Shkup.

Në këtë takim fjalë rasti pati Xhelal Bajrami, ministër i Punës dhe Politikës Sociale, Vasko Naumovski, nënkryetar për çështje evropiane, Ervan Fuere, shef i Delegacionit të BE në RM dhe përfaqësues special i BE, si dhe dy ko-kryetarët, Vlladimira Dërballova dhe Sasho Klekovski. Në takimin e dytë u prezantuan raportet për të drejtat ekonomike dhe sociale, ndërsa u miratuan edhe përfundimet të cilat përfshijnë disa segmente: rruga e Republikës së Maqedonisë drejt Bashkimit Evropian, të drejtat ekonomike dhe sociale, politikat për inkluzion social dhe aktivitetet e ardhshme.



Foto. 12 Nga e majta: Ervan Fuere, Xhelal Bajrami, Sasho Klekovski, Vlladimira Dërballova dhe Vasko Naumovski

Takimi i tretë u mbajt më 8 korrik në Bruksel. Në mbledhje u prezantua dhe diskutua Raporti për politikë transportuese. Mbledhja përfundoi me miratimin e dy grupeve të përfundimeve. I pari ka të bëjë me rrugën e Maqedonisë drejt BE, derisa grupi i dytë i përfundimeve ka të bëjë me politikën transportuese.

Në shtator u mbajt takimi përfundimtar i anëtarëve nga Maqedonia të KPK në mandatin 2009-2010, ku u prezantua Raporti për punën e PKK për periudhën dhjetor 2007 – korrik 2010. MCMS u zgjodh për anëtar i PKK edhe për mandatin e ardhshëm dyvjeçar.

PROCES I MBESHTETUR EUROINTEGRUES DHE BASHKËPUNIMI RAJONAL



MENAXHIMI ME RRJETIN BALLKANIK PËR ZHVILLIMIN E SHOQËRISË CIVILE

Rrjetin Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN) e përbëjnë 12 organizata qytetare nga 9 vende nga rajoni i Ballkanit: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Romania, Sllovenia dhe Serbia. MCMS udhëheq me zyrën ekzekutive të BCSDN.

Në vitin 2010 u anëtarësua Instituti për demokraci dhe Mediacion (IDM) nga Shqipëria, ndërsa filloi edhe procedura për pranimin në anëtarësi të TUSEV nga Turqia. U realizua edhe hulumtimi për gjendjen me dialogun qytetare në vendet e rajonit, që u prezantua përmes dokumentit politik (policy paper). U vendosën kontakte të reja me rrjetet si ALDA (Asociacioni i agjencive për demokraci lokale) dhe CEECN (Rrjeti qytetar i Evropës Qendrore dhe Lindore), Oneworld, ndërsa rrjeti u promovua në disa ngjarje si praktikë pozitive në rrjetëzimin rajonal të SHC.

DIALOGU QYTETAR NË BALLKANIN PERËNDIMOR

BCSDN e botoi publikimin “Hallka që mungon”? Zhvillimi dhe funksionimi i dialogut qytetar në Ballkanin Perëndimor”, dokument strategjik i cili është vazhdim i përpjekjeve të BCSDN t’u ofrojë edhe palëve të prekura ndërkombëtare dhe lokale, veçanërisht institucioneve të BE, analiza dhe rekomandime për zhvillimin e shoqërisë civile në Ballkan me fokus të rolit të tij në procesin e anëtarësimit drejt BE.



Foto. 13 “Hallka që mungon” u promovua në Bruksel

Dokumenti fokusohet në analizimin e situatës aktuale në zhvillimin dhe funksionimin e dialogut qytetare në shtatë vendet e Ballkanit Perëndimor në procesin e (para) qasjes drejt BE. Më tej, jep përfundime për atë si politika për zgjerim e BE do të mund të jep mbështetje në përpjekjet aktuale lokale edhe në nivel rajonal edhe nacional, me rekomandime në të cilat në mënyrë të barabartë do të përqendrohen të gjitha tre palët e prekura – KE, qeveritë nacionale dhe shoqëria civile.

Dokumenti është përgatitur me mbështetje të UKaid nga Ministria për zhvillim ndërkombëtar të Britanisë së Madhe (DFID) dhe Fondit Ballkanik për Demokraci (BTD).

PARTNERITETE, MARRËDHËNIET ME OPINIONIN DHE MBËSHTETJA

MARRËDHËNIET ME AKTORËT

Bashkëpunimi i MCMS zhvillohej me organizatat dhe institucionet e vendit, me agjencitë anëtare të Këshillit Botëror të Kishave dhe me organizatat tjera të huaja.

Këshilli i PQM miratoi vendim edhe për regjistrimin e PQM. MCMS në mënyrë aktive mori pjesë në përgatitjen e dokumenteve të nevojshme për regjistrimin e PQM, para së gjithash në propozim-statutin. Në nëntor MCMS dhe drejtori i saj i parë ekzekutiv, Sasho Klekovski përsëri u zgjodhën anëtarë në KPK për mandatin e ardhshëm dyvjeçar.

Në vitin 2010, anëtarët e Lidhjes “Maqedonia pa diskriminim” punuan në mënyrë intensive në përgatitjen dhe lobimin për Ligjin për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.



Foto. 14 Një nga takimet e Trupit koordinues nacional

Aktivitetet pas miratimit u fokusuan në hapat vijuese për zbatimin e tij.

Vazhdoi bashkëpunimi intensiv me institucionet shtetërore, më së shumti për shkak të aktiviteteve për mbështetje dhe lobim të ligjeve për shoqatat e qytetarëve dhe fondacioneve dhe për jo diskriminim.

Bordi i drejtorëve mori pjesë edhe në konsultimet e Sektorit për çështje evropiane (SEP) për Programin nacional për miratimin e të drejtës së Bashkimit Evropian, gjegjësisht revizionin e tij të parë për vitin 2010. MCMS mori pjesë edhe në konsultimet e SEP për programimin e IPA 2011.

MCMS në vitin 2010 filloi bashkëpunim më intensiv me Komisionin shtetëror për pengimin e korrupsionit, që u bë formale me nënshkrimin e memorandumit për bashkëpunim. Përfaqësues të MCMS ishin anëtarë të grupit punues për përgatitjen e Programit shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe Programit shtetëror për parandalimin dhe zvogëlimin e dukurisë së konfliktit të interesave 2011-2015.

Aleksandar Kërzhhalovski, drejtor ekzekutiv i MCMS vazhdoi me pjesëmarrje aktive në NSEI, si përfaqësues i PQM.

Bashkëpunimin rajonal MCMS para së gjithash e realizoi përmes Rrjetit Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile.

MARRËDHËNIET ME OPINIONIN

Gjatë vitit 2010 u botuan 12 numra të e-buletinit. Raporti vjetor u botua në formë elektronike (në CD) në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze. Ueb-faqja vazhdimisht azhurnohet, ndërsa një pjesë e përmbajtjeve të saja publikohen edhe në mediumet tjera sociale, duke mundësuar në këtë mënyrë dukshmëri për punën e MCMS.

MBËSHËTETJE – MCMS I QËNDRUESHËM

QASJA DREJT BURIMEVE TË FINANCIMIT

Në vitin 2010 u përgatitën dhe u dorëzuan gjithsej 19 aplikacione të reja, prej të cilave tetë ishin propozime për projekte (grante), gjashtë për dhënien e shërbimeve dhe pesë për shprehje të interesit për pjesëmarrje në thirrje për shërbime. Nga aplikacionet e vitit të kaluar, për dy u kërkuan dokument plotësues, që është hapi i fundit para miratimit të tyre, dy u pranuan, ndërsa dy u refuzuan..

VULLNETARIZMI DHE PRAKTIKA

Interesimi për vullnetarizëm në MCMS po rritet, kështu në vitin 2010 pati gjithsej 27 paraqitje për vullnetarizëm. Në vitin 2010 pati tetë vullnetarë, të cilët u seleksionuan në bazë të interesimit të tyre dhe nevojave të MCMS. Amerikan kolegji kërkoi bashkëpunim për pranimin e studentëve për mësim praktik në MCMS.

BËHUNI AKTIV – VULLNETARIZONI !

“Para se të filloj me vullnetarizmin, hulumtoja në internet organizatat qytetare në Maqedoni dhe për qëllimet e tyre”, thotë Simona Ognenovska, një nga vullnetaret. “MCMS e ruajti interesimin tim pasi që pati ueb faqe mirë të organizuar, ku mund ti gjeja të gjitha informatat e nevojshme , që për mua është tregues për funksionimin e organizatës”, tha Simona.



Foto. 15 Vullnetarët në MCMS mund ta shohin procesin e punës nga brenda

Për një pjesë të vullnetarëve kjo është përvoja e parë më serioze. Megjithatë, sipas tyre, akomodimi nuk është i vështirë. “Atmosfera e këndshme, mundësia për shprehje të lirë të ideve, mbështetja e vazhdueshme dhe durimi nga ana e të punësuarve ndaj nesh, vullnetarëve me më pak përvojë, kontribuoi shpejt të inkorporohemi në mjedisin e MCMS dhe të fitojmë njohuri të ndryshme”,

thotë Simona. “Ka shumë punë të cilat mund të mësohen, ndërsa të cilat nuk i kam ditur”, thotë Aleksandra Tilevska. “Mora shumë informata, për mënyrën e realizimit të projekteve, që përfshin, si formulohen qëllimet etj. Vullnetarizmi në përgjithësi është një përvojë plus që më tej do të më nevojitet në jetë”, shtoi ajo. “Mendoj se studentët në Maqedoni në vend të presin punësim, duhet në mënyrë aktive të inkuadrohen dhe të vullnetarizojnë në organizata qytetare, ku do të mund ti mbështesin njohuritë e tyre teorike me ato praktike, të njoftohen me funksionimin e organizatave dhe përmes kësaj të kontribuojnë për arritjen e disa qëllimeve më të larta, të cilat do të jenë të dobishme për bashkësinë ku ata jetojnë”, thotë Simona.

MCMS do të vazhdojë me këtë praktikë edhe në të ardhmen, duke u mundësuar të rinjve ta shohin procesin e punës nga brenda dhe duke u përgatitur për sfidat në jetë.

ORGANIZIMI

KËSHILLI

Ahmet Jasharevski
 Behixhudin Shehapi
 Bekim Ymeri
 Biljana Gerasimovska-
 Kitanovska
 Vlladimir Todoroviq
 Gazmend Ajdini
 Dilbera kamberovska
 Dushica Perishiq
 Dushko Kantarxhiev
 Gjoko Gjorgjevski
 Gjuner Ismail
 Elena Nikolova
 Zvonko Shavreski
 Ilo Trajkovski
 Jagup Selimoski
 Kelmend Zajazi
 Koço Angjushev
 Mihail Cekov
 Pepo Levi
 Rami Qerimi
 Ratko Llazarevski
 Rizvan Sulejmani
 Sllavko Veleovski



Foto. 16 Një nga mbledhjet e Këshilli të MCMS

KD

1. Rizvan Sulejmani, kryesues, doktor i shkencave politike, drejtor Institutit për studime politike dhe ndërkulturore në Shkup
2. Koço Angjushev, zëvendës kryesues, doktor i shkencave teknike
3. Biljana Gerasimovska-Kitanovska, mjek i mjekësisë së përgjithshme, magjistër i neurologjisë, e punësuar në Qendrën klinike Shkup, anëtare e ESE-Shkup
4. Behixhudin Shehapi, kryetar i El Hilal, Shkup
5. Goran Mihajlovski, kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës i "Vest"
6. Gjoko Gjorgjevski, Kisha Ortodokse Maqedonase
7. Jagup Selimoski, Bashkësia Islame e Maqedonisë
8. Sllavko Veleovski, kryetar i komunës së Mogillës



Foto. 17 Të punësuarit në MCMS

PERSONELI

Në fund të vitit 2010 MCMS pati 24 bashkëpunëtorë, prej të cilëve 20 me marrëdhënie të plotë pune, ndërsa katër bashkëpunëtorë me marrëdhënie të plotë pune në kohë të caktuar.

ZYRA EKZEKUTIVE

DREJTOR I PARË EKZEKUTIV

Sasho Klekovski
skl@mcms.org.mk

DREJTOR EKZEKUTIV

Aleksandar Krzhallovski
akr@mcms.org.mk

GRUPI PËR ZHVILLIM

Dimçe Mitreski
dmt@mcms.org.mk
Goran Jordanoski
gjr@mcms.org.mk

GRUPI PËR PUNËSIM

Tetjana Llazarevska
tlz@mcms.org.mk
Llazar Nedanoski
lnd@mcms.org.mk
Gligor Mihaillovski
gmh@mcms.org.mk

GRUPI PËR SHOQËRI CIVILE

Emina Nuredinoska
enr@mcms.org.mk
Valentina Çiçeva
vch@mcms.org.mk

Daniela Stojanova

dsj@mcms.org.mk

Marija Sazdeski

msz@mcms.org.mk

Emil Mahmutoviq

emh@mcms.org.mk

GRUPI PËR INFORMATA

Gonce Jakovleska

gjk@mcms.org.mk

Gramoz Shabani

gsb@mcms.org.mk

Boris Ristovski

brs@mcms.org.mk

MARRËDHËNIET MES BASHKËSIVE DHE BALLKANI

Tanja Hafner-Ademi

thf@mcms.org.mk

Dervisha Haxhiq-Rahiq

dhd@mcms.org.mk

Illina Neshiq

ins@mcms.org.mk

GRUPI

ADMINISTRATIV

Milka Bozhinovska-
Miova

mmv@mcms.org.mk

Krenar Kuka

kkk@mcms.org.mk

Adis Rahiq

arh@mcms.org.mk

Danillo Mitov

dmv@mcms.org.mk

Vesna Bogdanovska

vbg@mcms.org.mk



MENDIM I PAVARUR I REVIZOREVE

Deloitte.

Deloitte DOO
ML Teodosij Gologanov 28
1000 Skopje
Republic of Macedonia

Tel: +389 (2) 3111 300
Fax: +389 (2) 3119 544
centrmacedonia@deloittece.com
www.deloitte.com/Macedonia

Central Register of RM
Registry Number 4881427
Komerčajna Banka AD, Kej
Dimitar Vlahov, Skopje
Account no. 300-000000910-22
VAT MK 4030994253680

ИЗВЕШТАЈ НА НЕЗАВИСНИТЕ РЕВИЗОРИ

До Советот на Македонски центар за меѓународна соработка

Извршивме ревизија на приложените финансиски извештаи (стр. 2–23) на Македонски центар за меѓународна соработка (во понатамошниот текст „МЦМС“), кои се состојат од извештај за финансиската состојба на 31 декември 2010 година, извештај за сеопфатната добивка, извештај за промените на главнината и извештај за паричните текови за годината која тогаш завршува и преглед на значајни сметководствени политики и останати белешки.

Одговорност на раководството за финансиските извештаи

Раководството е одговорно за подготвувањето и објективното презентирање на финансиските извештаи во согласност со Меѓународните стандарди за финансиско известување и за одржување на интерна контрола која што е релевантна за подготвувањето и објективното презентирање на финансиските извештаи кои што се ослободени од материјално погрешно прикажување, без разлика дали истото е резултат на измама или грешка.

Одговорност на ревизорот

Наша одговорност е да изразиме мислење за овие финансиски извештаи, врз основа на нашата ревизија. Ние ја извршивме нашата ревизија во согласност со Меѓународните стандарди за ревизија. Овие стандарди бараат да ги почитуваме етичките барања, да ја планираме и извршиме ревизијата на начин кој ќе ни овозможи да добиеме разумно уверување дека финансиските извештаи се ослободени од материјално погрешно прикажување.

Ревизијата вклучува спроведување на постапки за прибавување на ревизорски докази за износите и обелоденувањата во финансиските извештаи. Избраните постапки зависат од расудувањето на ревизорот, вклучувајќи ја и проценката на ризиците од материјално погрешно прикажување во финансиските извештаи, без разлика дали е резултат на измама или грешка. При проценувањето на овие ризици, ревизорот ја разгледува интерната контрола релевантна за подготвувањето и објективното презентирање на финансиските извештаи на ентитетот со цел дизајнирање на ревизорски постапки коишто се соодветни на околностите, но не за цел на изразување на мислење за ефективност на интерната контрола на ентитетот. Ревизијата исто така вклучува и оценка за соодветноста на користените сметководствени политики и на разумноста на сметководствените проценки направени од страна на раководството, како и оценка на сепкупното презентирање на финансиските извештаи.

- Веруваме дека прибавените ревизорски докази се достатни и соодветни, за да обезбедат основа за нашето ревизорско мислење.

Мислење

Според наше мислење, финансиските извештаи ја презентираат објективно, во сите материјални аспекти, финансиската состојба на Македонски центар за меѓународна соработка на 31 декември 2010 година, како и резултатите од работењето и паричните текови за годината која тогаш завршува, во согласност со Меѓународните стандарди за финансиско известување.

Дилоит ДОО
Скопје
9 март, 2011

Deloitte doo

Превод на оригиналниот текст на Извештајот издаден на англиски јазик.
Audit, Tax, Consulting, Financial Advisory,

Member of
Deloitte Touche Tohmatsu

RAPORT FINANCIAR

BILANC I KONSOLIDUAR I GJENDJES MË 31 DHJETOR 2010 (shumat janë në mijëra denarë maqedonas, 1 EUR = 61,4123)

Përshkrimi	Vërej.	2010	2009
A. MJETE			
Mjete të përhershme			
Mjete themelore	2	13,686	13,970
Investime jo materiale	3	660	660
Fondi për shtëpi	4	7,604	7,696
Gjithsej mjete të përhershme		21,950	22,326
Mjete qarkulluese			
Mjete në të holla	5	11,908	49,156
Avance	6	2,414	4,660
Kërkesa nga blerësit	7	2,617	2,170
Kërkesa afatshkurta financiare	8	61,501	38,500
Kërkesa të tjera	9	7,613	7,759
Gjithsej mjete qarkulluese		86,053	102,245
GJITHSEJ MJETE		108,003	124,571
B. OBLIGIME DHE FONDE			
Obligime afatshkurta			
Obligime ndaj furnizuesve	10	6,457	506
Obligime tjera afatshkurta	11	1,473	910
Gjithsej obligime afatshkurta		7,930	1,416
Përkufizime pasive kohore	12	1,003	9,779
Gjithsej përkufizime pasive kohore		1,003	9,779
Të ardhura të pranuar për vitet e ardhshme	13	3,727	14,421
Gjithsej obligime		12,661	25,616
Rezervime për shpërblime dhe beneficione tjera për të punësuarit	14	454	416
Fonde dhe rezerva			
Fonde	15	98,538	99,750
Dallimi të ardhura/shpenzime në periudhën në rrjedhë		-3,651	-1,212
Gjithsej fonde dhe rezerva		94,888	98,955
GJITHSEJ OBLIGIME DHE FONDE		108,003	124,571

BILANC I KONSOLIDUAR I TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE MË 31 DHJETOR 2010 (shumat janë në mijëra denarë maqedonas, 1 EUR = 61,4123)

Përshkrimi	2010	2009
A. TËARDHURA		
Donacione dhe grante		
Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim	30,119	10,199
Sokotab dhe partnerët, Zvicër	6,024	3,059
Servisi Zhvillimor Kishtar (EED), Gjermani	4,304	14,807
Asociacioni Norvegjez i Komunave (KS)	3,977	28,711
Komisioni Evropian (KE)	4,688	3,490
Ndihma Kishtare Daneze (DCA)	1,690	0
Donatorë të tjerë	251	2,189
Gjithsej donacione dhe grante	51,042	68,399
Të ardhura personale		
MRFP	7,165	7,420
OSBE	4,643	2,044
BCSDN	1,100	0
MNI	1,294	0
Të ardhura tjera personale	55	2,163
Gjithsej të ardhura personale	14,257	11,627
Interes dhe dallime pozitive të kursit	4,551	5,936
Të ardhura të jashtëzakonshme	683	1,044
GJITHSEJ TË ARDHURA	70,533	87,006
B. SHPENZIME		
	2010	2009
Projekte për modernizimin e arsimit (PMO)	6,097	5,940
Fondacioni Zhvillimor Maqedonas për Ndërmarrje (MRFP)	7,781	7,308
Maqedonia pa diskriminim (MBD)	2,366	4,598
Modeli për dialog mes kulturave (MDK)	6,222	3,538
Zhvillimi lokal dhe rural (LRR)	2,280	11,272
Furnizimi me ujë i komunës së Jegunovcit (VOJ)	5,132	29,982
Udhëheqja e mirë në Maqedoni (DUM)	31,997	8,067
Zhvillimi institucional i shoqërisë civile (IRG)	7,647	6,856
Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN)	1,548	2,863
SHQAF	2,771	3,043
GJITHSEJ SHPENZIME	73,843	87,824
Tatimi	-341	-394
BILANCI	-3,651	-1,212

Botues

Qendra Maqedonase
për Bashkëpunim Ndërkombëtar

Adresa e botuesit

Qendra Maqedonase
për Bashkëpunim Ndërkombëtar
Rr. "Nikolla Parapunov" p.n.
f.p. 1060 Shkup
Republika e Maqedonisë

Tel.: 02/3065-381; faksi: 02/3065-298

e-mail: mcms.org.mk

www.mcms.org.mk

Drejtor i parë ekzekutiv

Sasho Klekovski

Drejtor ekzekutiv

Aleksandar Kërzhallovski

Redaktor përgjegjës

Gonce Jakovleska

Ndihmës redaktor

Gramoz Shabani

Fotografitë

Foto arkivi i MCMS

Dizajni

Koma lab.

